



## KËSHILLA RRETH INFEKSIONEVE QË BARTEN NË RRUGË SEKSUALE

DET HËR ËR EN ÖVERSÄTTNING TILL ALBANSKA AV FAKTABLADET RÅD OCH FAKTA OM SEXUELLT ÖVERFÖRDA INFEKTIONER – MYCOPLASMA GENITALIUM.

# Mycoplasma genitalium

**Mycoplasma genitalium** është baktere që bartet në rrugë seksuale në rast të seksit vaginal dhe anal dhe në rast të kontaktit të afërt të mukozave, dhe mund të shkaktoj infeksion në organin gjenital. Ky infeksion është përgjysmë më i përhapur se sa chlamydia tek pacientët që ekzaminohen për sëmundje që barten në rrugë seksuale.

**Mycoplasma genitalium** mund të gjendet në kanalet e urinës, vaginë dhe në zorrën e trashë dhe nganjëherë mund të shkaktoj infeksione të komplikuara siq është pezmatimi i përcuesve vezor tek femrat. Në raste të rralla shkakton edhe infeksione në sy. Ky infeksion nuk gjendet në grykë

### Simptomet e mycoplasma-s

Simptomet janë sikurse të chlamydia-s. **Mycoplasma genitalium** mund të shkaktoj bezdi në kanalën e urinës si të meshkujt ashtu edhe të femrat – djegie në rast urinimi, kruarje dhe bezdi në kanal urine e nganjëherë edhe sekrecion. Femrat mund të kenë edhe sekrecione nga vagina dhe gjakderdhje në mes të ciklit menstrual dhe dhembje në fund të barkut. Meshkujt mund të kenë pezmatim në epididimis (mbiherdhe) me dhembje dhe të ajur në gjysmën e herdhes.

### Testimi

Testimi për **Mycoplasma genitalium** rekomandohet vetëm në rast të simptomeve dhe shenjave të sëmundjes. Më së herëti një javë pas infektimit mund të konstatohet prania e bakteres në testim. Meshkujt mund të lënë analizë urinë ndërsa femrat mund të kombinojnë me analizë nga vagina ose qafa e mitrës. Mund të bëhet edhe analiza nga zorra e trashë nëse ke pasur seks anal ndërsa në rast infeksioni të syve, analiza merret në sy.

### Mjekimi

Infeksioni **Mycoplasma genitalium**, trajtohet me antibiotikë që përshkruhet në recetë. Terapia që jepet kundër chlamydia-s zakonisht nuk është efektive kundër **Mycoplasma genitalium**. Terapia nuk është falas sepse sëmundja nuk përfshihet nga ligji për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse. Është e rëndësishme që të mos kesh seks apo kontakt të afërt mukozash më dikë gjatë terapisë. Testim kontrollues mund të bëhet tre deri katër javë pas përfundimit të terapisë. Nëse ke sërish bezdi pas përfundimit të terapisë atëherë duhet gjithmonë të bësh testimin kontrollues. Ndodh që terapia nuk ka efekt andaj duhet përdorur një antibiotikë tjetër.

Nëse ke partner të rregullt duhet që edhe ai apo ajo të testohet dhe të marrë terapinë përndryshe ti rrezikon që të infektosh përsëri.

### Të mendosh rreth mycoplasma-s

Ti mund të fitosh shumë infeksionin **Mycoplasma genitalium**.

**Mycoplasma genitalium** është gjetur në rast të pezmatimeve në qafë të mitrës dhe në vezore por në përmasa më të vogla se sa në rast të chlamydia-s. Kjo baktere është gjetur edhe me rastin e pezmatimit në epididimis tek meshkujt. Meqënëse njohuritë rreth kësaj sëmundje janë të reja, akoma nuk janë studiuar vështirësitë për të bërë fëmijë, me rastin e këtij infeksioni.

